

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"MEDICUS LAB " Sh.P.K

Në këtë statut :

- " Ligji " është Ligji Nr . 9901 ,dt 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- "Statuti " Është Statuti I Shoqërisë.

Kreu I

Themelimi ,Emri , Objketi ,Kohëzgjatja ,Selia

Shoqëria me përgjegjësi të Kufizuar "MEDICUS LAB" Sh.P.K themelohet në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë shoqëri.

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me date **08/ QERSHOR / 2023** , Une Themeluesi, **Artur Çomollari** kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin "MEDICUS LAB " Sh.P.K

Themeluesi e Shoqërisë janë Ortaket :

1. **Artur Çomollari** ,me nr ID J11020086J lindur me 20.10.1991 , në Ballaban dhe banues në Shkoder.

Neni2

Objkti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e poshte - shenuar :

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

"Laborator Dentar"

NENI 3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërise "MEDICUS LAB" Sh.P.K , do te jete për një periudhe të papërcaktuar.

Neni4
Adresa e Shoqërisë

Selia e Shoqërise ndodhet në adresen :

SHKODER, Rruga Qemal Dracini, ZK 8592 nr/ pasurie 1/ 1406 + 3-29, Kodi Unik 85920430541

Kreu II
Kapitali i Regjistruar

Neni 5
Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar ,fillestarë I shoqërise "MEDICUS LAB " Sh.P.K eshte 100,000.00 (Nje qind mije) Leke.
Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Artur Çomollari**: Zoterues i **1** (Nje) kuote me vlere te pergjithshme **100.000 (Nje qind Mije) leke** përben **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni6

Zmadhimi dhe Zvoglimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyre ,nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një Eksperti të autorizuar ,për këto contribute sipas kërkesës së administratorit.
Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak ,për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvoglimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve , e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvoglimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjeseve të kapitalit që përfaqësojnë .

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë ;
- b) shit-blerjes;
- c) trashëgimisë ;
- ç) dhurimit ;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj .

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve ,për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Kreu III

ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendim-marrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organ i vetëm vendim-marrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendim-marrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- dh) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën (c) dhe (ç) të kësaj pike.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë .
- f) Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit të shoqërisë.
- g) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- h) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera të administratoreve .

- i) Riorganizimin dhe Prishjen e shoqërisë.
- j) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të Asamblesë.
- k) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji dhe statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme ,në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga nje person I tretë.

Administratori I shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues I ortakëve në asamblenë ë përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme ,e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Thirrja e Asamblese së Përgjithshme

1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike.Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakëve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te mane vendime te vlefshme vetern nese te gjithe ortakët jane dakord, per te mane vendime, pavaresisht parregullsisë.

Neni 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve ,që kerkojnë një shumice të zakonshme ,asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjese ortakët me të drejtë vote ,që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje ,të cilat kërkojnë shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te Ligjit “ Per Tregtarët dhe shoqërite Tregtare “ ajo mund te marrë vendime të vlefshme vetëm,nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votive,janë të pranishëm përsonalisht ,votojnë me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 të nenit 88 të ketij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund te mblidhet për shkak të mungeses së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë ,me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votive te zotëruesve të kapitalit ,të ortakëve pjesëmarrës,për ndryshimin e statutit ,Zmadhimin ose Zvoglimin e Kapitalit të rregjistruar,shpërndarjen e fitimeve ,riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votive te ortakëve pjesëmarrës ,për çështje te tjera si:

- a) Përcaktimi I politikave tregtare të Shoqërisë
 - b) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorëve
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e Likujduesve dhe te Ekspertëve kontabel te Autorizuar
 - d) Percaktimin e Shpërblimeve
 - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoret ,perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise së veprimtarise se Shoqërisë
 - f) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve te asamblesë.
- Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e Shoqërisë.

Neni 12
Votat e Ortakeve

(1) Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, cdo kuote i jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishern apo perfaqesuesit te tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik) i cili eshte i pranishem permes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.

(2) Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.

(3) Cdo kundërshtim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar, Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

Neni 13
Përrjashtimi nga e drejta e Votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e pergjithshme merr vendim për :
 - a) Vlerësimin e Veprimtarisë së tij;
 - b) Shuarjen endonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria ;
 - d) Dhenien ose jot ë perfitimeve te reja ;
2. Kur ortakut përfaqësohet nga nje përfaqesues i autorizuar ,I autorizuari vlerësohet te jetë në të

njëtin konflikt interesi ,ashtu si dhe ortaku ,të cilin përfaqeson.

Neni 14

Emerimi i Administratoreve


1. Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose disa persona fizike si Administrator të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emerimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marre me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pa vlefshëm.
3. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.
4. Personi i mëposhtem caktohet si **Administrator i shoqërisë**.

Te dhenat e identifikimit: (Emri, Mbiemri dhe adresat):

1. **Arjen Zeqiri** biri i Smajl, me nr ID J4016039F lindur me 16.01.1994, lindur në Shkoder dhe banues në Shkoder
Nga Data 08/06/2023 deri 08/06/2028

Dhe specimentet e nënshkrimit:

Nënshkrimi (Specimeni)



Neni 15

Kompetencat e Administratoreve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të :

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme ;
- b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare ;
- c) Kujdeset për mbajtjen sakte e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithshme për miratim ;
- e) Të kryejnë detyra të percaktuara në ligj dhe në statut ;
- f) **Detyra e Administratorit përfundon në rast se:**

1. Personi nuk është me Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
 2. Personi ndodhet në gjendje pa aftësi paguese;
 3. Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- g) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose ka munguar, për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16

Mbledhjet e Asamblese së Përgjithshme

- (1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortaket që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit **PIN** që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme.
- (2) Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- (3) Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishëm dhe me të drejtë të zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (4) Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblese së Përgjithshme.
- (5) Kryetari, me pëlqimin e Asamblese së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohej nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblese së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të para përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhenia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- (6) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohej në mënyrë të duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohej nga:
Kryetari; ose
1. një ortak ose ortaket që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themelues të shoqërisë.
Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vete ortakut,

1. Personi nuk është me Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
 2. Personi ndodhet në gjendje pa aftësi paguese;
 3. Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- g) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose ka munguar, për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16

Mbledhjet e Asamblese së Përgjithshme

- (1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortaket që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit **PIN** që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme.
- (2) Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- (3) Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishëm dhe me të drejtë të zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (4) Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblese së Përgjithshme.
- (5) Kryetari, me pëlqimin e Asamblese së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohej nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblese së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të para përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhenia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- (6) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohej në mënyrë të duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohej nga:
Kryetari; ose
1. një ortak ose ortaket që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themelues të shoqërisë.
Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vete ortakut,

Neni 17

Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

1. Administratoret shperblehen ne baze te skernes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenin 97 te Ligjit.
2. Asambleja e Pergjithshme mund te parashikojë perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne Shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/ en, Ish- bashkeshortin/ en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.
3. Administratoreve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e Administratoreve ose te komiteteteve te Administratoreve ose te Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

Neni 18

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve ,per shkelje te ligjeve ,per shkelje te statutit ,apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe sjellin dem shoqerise ,l ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen ,per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e pergjishme te detyrimit te besnikerise ,sipas neneve 14 ,15, 17 e 18 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare “ ,administrator detyrohet :

1. a) Te kryej detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne tërësi ,duke l kushtuar vëmendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis ;
b) Të parandaloje dhe të menjanoje rastet e konfliktit , present apo te mundshem ,të interesave personale me ato te shoqerise ;
c)të ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem .
2. Administratori ,gjate kryerjes se detyres pergjigjet ndaj shoqerise ,për cdo veprim ose mosveprim ,që lidhet ne menyre të arsyeshme me qëllimet e shoqerise tregtare ,me përjashtim te rasteve kur , në baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Kreu IV

Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Neni 19

Dividendet

(1) Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te Ligjit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

(2) Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat, te gjitha dividendet deklarohen dhe paguhet ne perputhje me shumate e paguara per kuotat per te cilet paguhet dividendi. Te gjitha dividendet pjesetohen dhe paguhet ne proporcione te drejte me shumate e paguara per kuotat, pjeses ose pjesese te periudhes per te cilen paguhet dividendi; ne rast se kuota ernetohet me kushtin e pertitimit te dividendit nga nje date e caktuar, dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht,

(3) Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

(4) Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhete vjeteve nga data e maturimit, ne rast se vendoset me shumice te kualifikuar votash nga Asambleja e Pergjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaje ate.

Neni 20

Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit, mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

Kreu V

Neni 21

Viti Financiare

Viti Financiare I Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor . Perjashtimisht , viti I pare financiare fillon nga data e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 22
Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë vjetore dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai ngarkohet nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiarë vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

Këto raporte ai është i detyruar që këto raporte duhet t'ja paraqesë në kohë ortakeve për të shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu VI
Prishja dhe njoftimet

Neni 23
Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicën e kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakeve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë rrethën e shpërndarjes midis ortakeve të shoqërisë.

Neni 24
Njoftimet

(1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me leter porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepën përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.

Neni 25
Riorganizimi i Shoqërisë bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “

Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare “

Neni 26
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat ligjore të legjisllacionit Shqiptarë.
Për sa parashikohet në kete statut ,do të zbatohen dispozitat e Ligjit 9901 date 14.04.2012 “ Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare “ ,Kodi Civil dhe cdo ligj tjetër specifik në R.Shqipërisë.

Neni 27
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti si dhe për cdo mosmarreveshje qe mund të lindë mes shoqërisë dhe të tregëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve Themelues të Shoqërisë “MEDICUS LAB “ Sh.P.K:

1. Artur Çomollari

